



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



02 Nr. MMI-SB 997 dt. 21/11/2023

Në mbështetje të nenit 12, paragrafi 12.2 shkronja d), nenit 73, të Ligjit Nr- 03/L -040 për vetëqeverisjen lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008", neni 34 paragrafi 34,6 shkronja g), të Statutit të Komunës së Drenasit të datës 16.09.2008, si dhe të dispozitave të nenit 4,5 dhe 8 të Udhëzimit Administrativ, Nr-01/2016, për Procedurën e Themelimit, Organizimit dhe Kompetencave të Komiteteve Konsultative në Komuna, Kuvendi i Komunës së Drenasit, shpalli këtë:

RISHPALLJE E KONKURSIT
PËR FORMIMIN E KOMITETIT KONSULTATIV TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË
DRENASIT

1. Kuvendi i Komunës së Drenasit, shpall konkurs publik për formimin e Komitetit konsultativ të Komunës së Drenasit si në vijim:

Komiteti Për Arsim, Kulturë Rini dhe Sport

2. Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:

- 2.1. Kandidati duhet të jetë qytetar i Komunës së Drenasit;
- 2.2. Të jetë ekspert –përkatesisht njohës i fushës përkatëse;
- 2.3. Përbërja e Komitetit duhet të reflektojë përfaqësimin gjinor;
- 2.4. Komiteti do të jetë në përbërje prej pesë anëtarëve.

3. Kriteret për përzgjedhje:

- 3.1. Diplomë Universitare;
- 3.2. Njohës i mirë i fushës përkatëse ose anëtar i organizatës, e cila merret me lëmin përkatëse;
- 3.3. Të ketë aftësi komunikuese;
- 3.4. Të ketë aftësi ofrimi të njohurive në çështjet përkatëse;
- 3.5. Motivues i punës ekipore në mënyrë efektive.

4. Detyrat dhe përgjegjësitë e anëtarëve të Komitetit konsultativ:

- 4.1. Dhënia e propozimeve të rregulloreve të ndryshme;
- 4.2. Hulumtime të ndryshme, mendime dhe ide rreth iniciativave të ndërmarra nga Kryetari i Komunës, Komitetet e përhershme apo Kuvendi i Komunës në fushën përkatëse;

4.3. Paraqitja e pikëpamjeve dhe mendimeve të qytetarëve te Kryetari i Komunës dhe Kuvendi i Komunës;

4.4. Propozime për zgjidhjen e problemeve të identifikuara;

5. Mandati i anëtarëve:

Mandati i anëtarëve të Komitetit konsultativ është 4 (katër) vjeçar, nga dita e emërimit, me të drejtë të rizgjedhjes edhe për një mandat të dytë.

6. Dokumentet e kërkuara:

- 7.1 Diploma universitare;
- 7.2 CV personale;
- 7.3 Certifikata e lindjes;
- 7.4 Dëshmi për përvojën e punës për fushën specifike;
- 7.5 Vërtetimin që nuk është nën hetime;
- 7.6 Kopja e letërnjoftimit.

7. Afati i konkursit:

8.1. Konkursi është i hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga data e shpalljes së konkursit.

8.2. Aplikacionet merren dhe dorëzohen në zyrën për ofrimin e shërbimeve të qytetarëve ose përmes postës në adresën: Komuna e Drenasit rruga "Fehmi e Xhevë Lladrovci"

21.11.2023



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Milaim Hajdari